

Fillimi > -Kronikë

Hapi zjarr ndaj 1 personi në një lokal gjatë karantinës, policia prangos 38-vjeçarin nga Tropoja. Ja ngjarja për të cilën akuzohet

18 Janar, 2021 12:07 | 1 329 shfletime



Madhësia e tekstit: − +

f Policia ka arrestuar një 38-vjeçar nga Tropoja, që ishte shpallur në kërkim për veprat penale “Vrasja me paramendim”, mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit ushtarak”.

wa Shtetasi R.H akuzohet se së bashku me tjetër shtetas, ka dashur të vrasë me armë zjarri 1 person në një lokal gjatë karantinës, ndërsa policia bën edhe një përmbledhje të ngjarjes së ndodhur.

Njoftimi i policisë:

Tropojë

Vijon puna për kapjen e personave të shpallur në kërkim.

Kapet dhe vihet në pranga 38-vjeçari i shpallur në kërkim për veprat penale “Vrasja me paramendim” mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”.

Në vijim të punës për kapjen e personave të shpallur në kërkim, efektivët e Komisarariatit të Policisë Tropojë, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, pas lokalizimit të vendndodhjes, bënë kapjen dhe arrestimin e shtetasit:

R. H., 38 vjeç, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim, pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, në datën 14.07.2020, ka dërguar urdhër për ekzekutimin e vendimit penal të datës 07.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Tropojë, e cila i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Vrasja me paramendim” mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”.

Më datë 25.05.2020 është qëlluar me armë zjarri në drejtim të një lokali në fshatin Sopot, ku ndodheshin shtetasit B. Rr. dhe G. Rr. Në përfundim të veprimeve hetimore janë identifikuar dhe shpallur në kërkim autorët e dyshuar të kësaj ngjarjeje, shtetasit R. H. dhe G. K. Gjithashtu është shpallur në kërkim shtetasi G. Rr., i cili është kundërpërgjigjur me armë nga brenda lokalit, pas konfliktit për motive të dobëta.

Vijon puna për kapjen e shtetasve G. K. dhe G. Rr.

Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për veprime të mëtejshme.

(d.xh/ Balkanweb)

Për t'u bërë pjesë e grupit **"Balkanweb"** mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [arrestim](#) [policia](#) [Tropoje](#)

TË NGJASHME

Ishin shpallur në kërkim për falsifikim dokumentesh dhe ndërtim pa pasuri të një personi të dënuar për trafik droge

19 Janar, 2021

Kanosën pronarin e një lokali në Durrës dhe i thyen xhamat, arrestohen dy autorët. Ndjekje penale për dy të tjerë pasi...

19 Janar, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

“Më rrahu si gomari në duhan”, djali dhunon barbarisht të atin 92-vjeçar, gjykata e lë të lirë

20 Janar, 2021

EMRI/ Zbarchen pasuritë 5 mln € të sekuestruara në Tiranë, ja kush është mirditori i dënuar për trafik droge që i posedonte

20 Janar, 2021

Aksion në Tiranë/ Sekuestrohen 5 milion euro pasuri të një personi të dënuar për trafik droge

20 Janar, 2021

Në bashkëpunim me Kosovën, arrestohet pengëmarrësi 33 vjeçar nga Burreli, pritët ekstradimi (Ngjarja në 2019)

20 Janar, 2021

Nesër 10 vite nga protesta e përgjakshme e 21 janarit, Policia e Tiranës kërkon rihapjen e dosjes

20 Janar, 2021

Merr flakë makina në lëvizje në Tiranë, shpëton në kohë drejtuesi

20 Janar, 2021

KATEGORIA VIDEO



Politika e jashtme amerikane me Biden/ Ish-ambasadori Tarifa: Nuk ndryshon se erdhi President i ri, funksionon me interesa kombëtare

20 Janar, 2021



Inaugurimi i Biden/ Minxhozi: Dorëzimi i pushtetit në SHBA është kult, populli në Capitol u ngrit me një rrenë

20 Janar, 2021

“Patriotizmi, streha e fundit e maskarait”, ish-ambasadori shqiptar në SHBA: Trump qeverisi keq, nuk ishte më patriot se të tjerët

20 Janar, 2021

Birçe Hasko kujton xhirimet natën të filmit “Radiostacioni”: Ruajtja e godinës së Radio Tiranës është fisnikëri e kulturë

Fatmira Nikollë | 20 Janar, 2021

Nesër 10 vite nga protesta e përgjakshme e 21 janarit, Policia e Tiranës kërkon rihapjen e dosjes

20 Janar, 2021

Joe Biden betohet si President i 46-të i SHBA: Amerika u testua dhe u ngrit sërisht, më ndihmoni ta bashkoj!

20 Janar, 2021

BalkanWeb

FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert

Emisioni Chic

Emisioni Diplomaticus

Emisioni Vila 24

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Monitor Ekonomi

Real Story

Shqiptarët për shqiptarët

Sport News

Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today

